

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
Moveo Albania Technology SHPK

THEMELIMI

Neni 1
Ortakët themelues

- 1.1 Shoqëria **Moveo Albania Technology SHPK** themelohet nga Ortakët si më poshtë vijojnë:
- Shoqëria **MOVEO SRL**, me seli ne Milano Largo Richini 6. C.F, Nr. Rregjistrimi 07793020962 dhe,
 - **Z. Erion Isufi**, shtetas shqiptar, lindur më 21.03.1978 ne Tirane, me banim ne Rruga Ibrahim Rugova, Kati 6, Tirane, Shqiperi, mbajtes i Pasaportes me nr. H80321150G; dhe
 - **Z. Xhafer Isufi**, shtetas shqiptar, lindur më 14.01.1948 ne Tepelene, me banim ne Rruga Dervish Hima, Kati 9, Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. E80114073V.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është **Moveo Albania Technology**.

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar nepermjet Vendimit te Asamblese se Pergjithshme.

EBellij 19





Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të përcaktuar.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Njësia Bashkiake nr. 2, Sheshi Italia, Qendra Tregtare MAK ALBANIA, Mbrapa Stadiumit Qemal Stafa, Kati 2-te, Tirane.**
- 6.2 Shoqëria mund të themelojë/krijojë zyra (adresa) sekondare, degë ose njësi të tjera përfaqësuese si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë vendit me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë nepermjet blerjese se kuotave apo aksioneve ose të cilat mund të krijohen rishtazi në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 7
Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

E Belliu 19

[Signature]

[Signature]

- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar dhe do të propozohet nga Ortaket e shoqërisë.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: *Disenjim software-i. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike; Testim software; Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN); Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Zhvillim sistemesh migrimi. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software.*
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 9

Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 125'000 (Njëqind e njetete e pese mije) Leke.
- 9.2 Kapitali ndahet në 3 (tre) pjesë.
- 9.3 Pronësia e kuotave ndahet midis ortakëve si vijon:
- Shoqëria MOVEO S.R.L, zotëron 60 (gjashtedhjetë) % të kapitalit e barabartë me 1 kuote, me një vlerë të përgjithshme prej 75'000 Lekë

E Belliu 19

af

f.

- Z. Erion Isufi, zotëron 20 (njetete) % të kapitalit e barabartë me 1 kuote, me një vlerë të përgjithshme prej 25'000 Lekë.
- Z. Xhafer Isufi, zotëron 20 (njetete) % të kapitalit e barabartë me 1 kuote, me një vlerë të përgjithshme prej 25'000 Lekë.

9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Transferimi i kuotave. Kufizimet.

- 10.1 Gjate 2 viteve te para nga momenti i themelimit te shoqerise, transferimi i kuotave ndaj te treteve eshte e ndaluar.
- 10.2 Pas perfundimit te periudhes se percaktuar ne nenin 10.1, transferimi i kuotave te shoqerise do te lejohet vetem me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme me aprovimin e te pakten 61% te kapitalit te shoqerise.

Neni 11

Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

E Belliu





- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblesë së Përgjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Përgjithshme i cili është organi me i larte vendimarrës i Shoqërisë.
- 13.2 Cdo Ortak ka te drejten te marr pjese ne Asamblen e Pergjithshme, te shpreh mendimin e tij dhe te ushtroje te drejten e votes ne perpjestim me kuoten qe zoteron.
- 13.3 Cdo Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme nga nje person tjetër ne baze te nje autorizimi te thjeshte me shkrim sipas formatit te propozuar nga Administratoret e shoqërisë. Ne cdo rast, autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme dhe është e vlefshme per thirrjen e saj te pare dhe te dyte.
- 13.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet edhe ne vendodhje te ndryshme nga selia e shoqërisë, ne Shqiperi ose jashte saj. Është e lejueshme që mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës.
- 13.5 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret me kerkese te secilit nga Administratoreve dhe/ose Ortakeve te cilet zoterojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit themeltar.
- 13.6 Asambleja e Pergjithshme konsiderohet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te thirrjes, nese Ortaket qe perfaqesojne te gjithë kapitalin e Shoqërisë jane te pranishem ne mbledhje ose te perfaqesuar me autorizim.

E Bellin ¹⁹

or

f.

13.7 Ne rastin e vendimeve te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marr vendime te vlefshme nese jane prezent Ortaket qe zoterojne 30% te kapitalit te shoqerise. Mungesa e kuorumit konstitutiv pengon votimin. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit ne thirrjen e pare, Asambleja mund te mblidhet me te njejtin rend dite, brenda dhe jo me vone se 7 (shtate) pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme si ne thirrjen e pare dhe ne ate te dyte, merren me miratimin e te pakten 51% (pesedhjete e nje perqind) te kapitali te shoqerise, pervec rasteve kur ky statut parashikon ndryshme.

Asambleja e Zakonshme vendos per ceshtjet e meposhtme:

- a. Ndryshimin e selise dhe emertimin e shoqerise;
- b. Emerimin ose shkarkimin e administratorit ose administratoreve te shoqerise, miratimin dhe/ose amendimin dhe/ose zgjidhjen e Kontrates se Punes se tyre si dhe percaktimin e shperblimeve te tyre;
- c. Emerimin e eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se eshte e nevojshme si dhe percaktimin e shperblimeve te tyre;
- d. Miratimin e bilancit te shoqerise;
- e. Miratimin i cdo Kontrate e cila nuk permbush kushtet e percaktuara ne nenin 14 te ketij Statuti;
- f. Miratimin per shitjen e cdo asetit te shoqerise;
- g. Lende te tjera te parashikuara nga nenet e tjera te ketij Statuti dhe te Nenit 81 te Ligjit Nr. 9901/2008.

13.8 Ne rastet e vendimeve te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marr vendime te vlefshme nese jane te pranishem Ortaket qe zoterojne me shume se 61% (gjashtedhjete e nje perqind) te kapitalit te shoqerise. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit ne thirrjen e pare, Asambleja mund te mblidhet me te njejtin rend dite, brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme, si ne thirrjen e pare edhe ne thirrjen e dyte, merren me miratimin e tre te katertave te votave te Ortakeve qe marrin pjesë ne mbledhjen e Asamblesë.

Asambleja e jashtezakonshme vendos mbi ceshtjet e meposhtme:

- a. Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;
- b. Prishjen dhe likuidimin e shoqerise;

EBelliu 19

ST

F

- c. Ndryshimin e Statutit te shoqerise;
- d. Shperndarjen e fitimit dhe te dividenteve;
- e. Transformimin e shoqerise ne forma te tjera;

Neni 14 Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.2 Me vendim të Asamblese se Pergjithshme mund të emërohen përfaqësues ose administrator të tjerë, me kompetenca të përgjithshme ose të posaçme.
- 14.3 Administratorët e shoqërisë janë:
- **Z. Emiliano D'Agostino**, shtetas italian, lindur më 08.09.1975 ne Aversa (Ce) - Itali, banues ne Viale Kennedy 11, Cesa (Ce) Italia, mbajtes i Kartes se Identitetit AV 8643406, dhe
 - **Z. Erion Isufi**, shtetas shqiptar, lindur më 21.03.1978 ne Tirane, banues ne Rruga Ibrahim Rugova, Kati 6, Tirane, Shqiperi, mbajtes i Pasaportes me nr. H80321150G.
- 14.4 Administratorët kanë të drejtë të përfaqësojë shoqërinë bashkërisht ose vec e vec si dhe drejtojnë punën e përditshme të shoqërisë sipas kompetencave të përcaktuara nga ky Statut dhe në përputhje me udhëzimet dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.5 Administratorët do të veprojnë si dhe duhet të nënshkruajnë bashkërisht të gjitha aktet e nevojshme të lidhura me veprimtaritë e mëposhtme:
- a) Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
 - b) Të lidhin, të nënshkruajnë dhe zgjidhin/anullojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë Kontrata Konsulence duke perfshire por pa limituar te konsulenteteve ligjore, te konsulenteteve financiar etj;
 - c) Të lidhin, të nënshkruajnë dhe zgjidhin/anullojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë kontrata si me poshtë përcaktuar:

Bellij¹⁹

at f.

1. Cfarëdollojë Kontratë Kredie dhe cdo lloj tipi te kontratave bankare;
 2. Kontrata Sigurimi;
 3. Kontrata Leasing;
 4. Kontrata për shitjen – blerjen të pasurive të paluajtshme;
 5. Kontrata për shitjen apo disponimin e asetëve e shoqërisë dhe/ose të drejtat nën pronësi të saj;
 6. Kontratat e furnizimit të të gjitha llojeve;
- d) Krijimin e një sistemi paralajmërimi për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) Raportojnë cdo vit përpara Asamblese se Pergjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të vecantë për shoqërinë;
- f) Përgatisin dhe i propozojnë për miratim Asamblese se Pergjithshme cdo lloj Rregullore të Brëndshme dhe nënshkruajnë atë pas miratimit nga Asambleja e Pergjithshme me 61% te kapitalit te shoqerise;
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët përveç sa parashikohet nga neni 14.6;
- h) Përgatitja dhe nënshkrimi i çdo dokumenti administrativ dhe rregullator që nuk parashikohet në Nenin 14.6 të këtij Statuti;
- 14.6 Administratorët do të jenë përgjegjës dhe mund të kryejnë vec e vec veprimtarite e mëposhtme:
- a) Të përfaqësojnë shoqërinë në Shqipëri përpara cdo banke të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë;
 - b) Përgatitjen dhe nënshkrimin e dokumentave të ndryshme sipas kompetencave te tyre në emër të shoqërisë;
 - c) Të lidhë, nënshkruajë dhe zgjidhin/anulojë kontratat në emër dhe per llogari të shoqërisë me përjashtim të atyre te parashikuara ne nenin 14.5 dhe 14.7;
 - d) Administrimin e aktivitetit te perditshem dhe organizativ te shoqerise;
 - e) Kryerjen e rregjistrimeve të të dhënave të detyrueshme sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit;
 - f) Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër te shoqerise si dhe të nënshkruajë kontratën e punës me ta. Para fillimit ose përfundimit të çfarëdo marrëdhënieje pune, Administratorët duhet të informojnë paraprakisht njëri-tjetrin.

E Bellin 19

OK F

Nëse njeri prej Administratorëve vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, atëherë ai do t'i përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për dëmet dhe humbjet e shkaktuara;

- g) Nënshkrimin e deklarimeve të tatimeve apo cdo dokumenti tjetër i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve tatimore mujore për shoqërinë;
- h) Të thërrase Asamblenë e Përgjithshme;
- i) Leshimin e faturave në emer dhe për llogari të shoqërisë dhe/ose të pranojë fatura të leshuara kundrejt shoqërisë. Në këtë rast, Administratorët duhet të informojnë njeri – tjetrin për të gjithë shkresat, porosite apo çfaredolloj dokumenti tjetër që lidhet me faturimin dhe/ose porosi që do të leshohen nga ose kundrejt shoqërisë brenda 7 diteve. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, atëherë ai do të përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për dëmet dhe humbjet e shkaktuara;
- j) Të ndër marrin nisma gjyqësore në emër dhe për llogari të shoqërisë pas marrjes së miratimit të Asamblesë së Përgjithshme e cila aprovon me 61% të kapitalit të shoqërisë;

14.7 Asnjëri nga Administratorët qoftë bashkërisht apo vec e vec nuk duhet të:

- a. Kërkojnë, disponojnë apo lëshojnë cekë bankare. Cdo cek bank i lëshuar nga Administratorët do të jetë i absolutisht i pavlefshëm.
- b. Të delegojnë detyrat dhe të drejtat e atribuara nga ky Statut apo Ligji Nr. 9901 duke lëshuar ndaj personave të tretë Prokurë të Përgjithshme apo Prokurë të Posacme pa miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme e cila aprovon me 61% të kapitalit të shoqërisë.
- c. Të autorizojnë persona të tretë për të përfaqësuar shoqërinë përveç punonjësve apo konsulentëve për përfaqësimin e shoqërisë ndaj zyrave ose organeve administrative si dhe ndjekjen e procedurave, përfshirë nënshkrimin e akteve, përpara organeve ose zyrave Administrative.

14.8 Në rastet kur ky Statut u jep të drejtën Administratorëve për të lidhur dhe nënshkruar kontrata pa pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme atëherë Administratorët gëzojnë të drejtën edhe për amendimin dhe/ose zgjidhjen e të njëjtës Kontratë pa miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme. Në të kundërt zgjidhja dhe amendimi do të bëhet vetëm me

Bellij¹³

ost

f

miratimin paraprak të Asamblese se Pergjithshme me te njejten shumice votash me te cilen eshte miratuar.

- 14.9 Në rastet kur nevojitet miratimi paraprak i Asamblese se Pergjithshme, Vendimi aprovues duhet ti bashkëngjitet kontratave respektive, në të kundërt këto të fundit konsiderohet se nuk kanë hyrë kurrë në fuqi, dhe Administratorët mbajnë përgjegjësi personale për kontratat e nënshkuara në kundërshtim me dispozitat e nenit 14 të këtij Statuti.
- 14.10 Në rastin kur njëri nga Administratoret shkarkohet ose jep dorëheqje, derisa në momentin e emerimit te nje Administratori nga Asambleja e Përgjithshme, Administratori i mbetur ne detyre do të ushtrojë të gjitha detyrat dhe të drejtat e përcaktuara në këtë Statut pa asnje kufizim.
- 14.11 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pese) vjet për secilin nga Administratorët me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 15

Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asamblesë së Përgjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

EBelliu 19

AT

f

- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, me vendim të Asamblese se Përgjithshme mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakët do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Financimet e Ortakeve dhe titujve te kredise

- 18.1 Përveç nëse përcaktohet ndryshe me vendim prej 61% të kapitalit të shoqërisë, huatë apo financimet e bëra nga Ortaket në Shoqëri konsiderohen si hua apo kredi pa interesa, edhe nëse ato kryhen jo në përpjesëtim me Kuotat që Ortaket zotërojnë në Shoqëri.
- 18.2 Shoqëria mund të lëshojë letra me vlerë të borxhit. Në këtë rast, kufijtë e mundshëm dhe modalitetet do të vendosen dhe miratohen me vendim të Asambles së Përgjithshme i miratuar nga 61% i kapitalit të regjistruar. Titujt leshuar në këtë kuptim mund të mund të regjistrohen vetëm ndaj investitorëve profesionistë. Në rast të qarkullimit pasues të titujve të borxhit, transferuesi është përgjegjës për aftësinë paguese të shoqërisë ndaj blerësve të cilët nuk janë investitorë profesionalë ose ortakë të vetë Shoqërisë.

Bellij 13

OK F.

Neni 19
Likuidimi

- 19.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 19.2 Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 19.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Përgjithshme do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 20
Mosmarrëveshjet

- 20.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 21
Klauzolë mbyllëse

- 21.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, datë 06/03/2019

Moveo Albania Technology SHPK
Ortakët

MOVEO S.R.L
Perfaqesuar nga

Egisa Hasanbelliu
Belliu 19

Z. Erion Isufi

ERION ISUFI
Isufi

Z. Xhafer Isufi

Xhafer Isufi
Isufi